



Dr. Dorina Xhani

Lektore në Departamentin e
Shkencave të Edukimit dhe
Trajnimit Profesional

BIOGRAFIA

Dorina Xhani është lektore në Departamentin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, Universiteti “Barleti”. Ka mbaruar studimet universitare për Punë Sociale dhe Politikë Sociale me rezultate shumë të mira në Universitetin e Tiranës, ato pasuniversitare Master në Studimet Evropiane në UT dhe ka mbrojtur doktoraturën me temë: “Aborti selektiv në Shqipëri, shkaqet dhe pasojat psikologjike” UT.

Prej vitit 2006 e në vazhdim eksperte në shërbime sociale si në institucione shtetërore të tilla si Ministria e Shendetësisë, SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, ashtu dhe OJF për ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për fëmijët si: Qendra TISS “Qendra e Shërbimeve dhe e Trajtimit Psikosocial” në pozicionin e drejtueses dhe menaxhimit të aktiviteteve dhe shërbimeve psiko-sociale.

Gjithashtu prej vitit 2014 lektore në FSHS-UT dhe në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, si dhe nga viti 2019 lektore në UET duke mbuluar disa cikle leksionesh në lëndë si: Metoda të Kërkimit Shkencor; Hyrje në Psikologji, Hyrje në Këshillim, Këshillimi në Familje, Teoritë në Këshillim dhe Psikoterapi, Teknikat e Këshillimit Psikologjik, Psikologji Edukimi e Avancuar.

Si eksperte në kërkimin shkencor ka marre pjesë në shumë Konferenca dhe Simpoziume Ndërkombëtare si dhe ka botuar një sërë artikujsh në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus.